



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.96/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 23.01.2025, merr këtë:

### **V E N D I M**

- I. Pranohen të bazuara ankesat e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.96/2025, Anr.97/2025 dhe Anr.98/2025, Anr.101/2025, Anr.102/2025 dhe Anr.103/2025, të datës 21.01.2025.
- II. Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 9.000.00, (nëntëmijë) Euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

### **A r s y e t i m**

Me datën 21.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuara Anr.96/2025, Anr.97/2025 dhe Anr.98/2025, Anr.101/2025, Anr.102/2025 dhe Anr.103/2025, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

-Në ankesën Anr.96/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Istog, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për deputet Besim Mulaj, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur mbi rrugët publike, konkretisht në rrugën "Skenderbeu" në Istog. Ky baner/poster është vendosur në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës.

-Në ankesën Anr.97/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Istog, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për deputet Besim Mulaj, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur mbi rrugët publike, konkretisht në rrugën "UÇK" në Istog. Ky baner/poster është vendosur në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës.

-Në ankesën Anr.98/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Istog, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për deputet Besim Mulaj, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur mbi rrugët publike, konkretisht në rrugën "Fehmi Agani", në Istog. Ky baner/poster është vendosur në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës.

-Në ankesën Anr.101/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Istog, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për deputet Besim Mulaj, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur mbi rrugët publike, konkretisht në rrugën "Bardh Isufi" në Qendër të Banjës së Istogut. Ky baner/poster është vendosur në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës.

-Në ankesën Anr.102/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Istog, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për deputet Besim Mulaj, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur mbi rrugët publike, konkretisht në rrugën "Lidhja e Pejës" në Istog ( afërsi të Restaurantit "Sharaz"). Ky baner/poster është vendosur në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës.

-Në ankesën Anr.103/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Istog, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për deputet Besim Mulaj dhe kandidatja për deputete Lisa Rugova, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur mbi rrugën publike, konkretisht në rrugën "Bardh Isufi" në Qendër të Banjës së Istogut ". Ky baner/poster është vendosur në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës.

Me këto veprime kandidatët dhe Subjekti Politik LDK, kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP.

Si provë për pretendimet në ankesa, parashtruesi ka bashkangjitur fotografi që dëshmojnë vendosjen e banerave/posterave në kundërshtim me LZP.

Më datë 22.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre.

Në përgjigjet në ankesë të Subjektit Politik LDK, thuhet se kandidati i subjektit në fjalë nuk kanë bërë shkeljen e dispozitat ligjore të nenit 34 paragrafi 1 , nen paragrafi 1 .2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sepse disa nga kandidatët për deputet nga radhët e Subjektit Politik LDK, dega në Istog, me rastin e vendosjes se materialeve reklamuese-postereve, posedojnë Pëlqim të përkohshëm për shfrytëzim të hapësirës publike, të lëshuar nga Komuna e Istogut — Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit.

Më tej në përgjigje në ankesë të Subjektit Politik LDK, theksohet se asnjë nga kufizimet e nenit 7 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës se Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, nuk ndërlidhen direkt apo indirekt me rastin në fjalë.

Si dëshmi në përgjigje në ankesë ka bashkangjitur Pëlqimet e përkohshme për shfrytëzimin e hapësirës publike, të lëshuara nga Kuvendi Komunal në Istog, dhe kërkojnë nga PZAP, që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e Subjektit Politik LVV.

*Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.96/2025, A.nr.97/2025, A.nr.98/2025 Anr.101/202, Anr.102/2025, dhe Anr.103/2025, të paraqitura me datë 21.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjen e përbashkët A.nr.96/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se :

**-Ankesat është e bazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndëve dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.*”

Ndërsa nga përgjigja në ankesë, e Subjekti Politik LDK, e cila referohet se disa nga kandidatët për deputet nga radhët e Subjektit Politik LDK, dega në Istog, me rastin e vendosjes se materialeve reklamuese-postereve, posedojnë Pëlqim të përkohshëm për shfrytëzim të hapësirës publike, të lëshuar nga Komuna e Istogut — Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit, të cilin e ka bashkangjitur provë në përgjigje.

Paneli gjatë shqyrtimit të provave gjegjësisht Pëlqimeve të dhëna nga Komuna e Istogut, për kandidatin Besim Mulaj, ka vërejtur se të njëjtit i është lëshuar për shfrytëzim të përkohshëm të hapësirave publike për vendosjen e reklamave *vetëm* në rreth rrotullimin i cili lidhë rrugët “Rr. Rinia”, Rr.” Nënë Tërëza”, Rr”Skënderbeu”, Rr “Ibrahim Rugova” si dhe në rreth rrotullimin tek Hotel Trofta që lidh rruga Bajram Gashi në Istog.

Ndërsa për kandidaten Lisa Rugovaj, Pëlqimi nga Komuna e Istogut i është dhënë tek Parku i Vogël afër rrugës “Skenderbeu” dhe rruga “Rinia” në Istog, si dhe në Ishullin në rrugën “Besim Kabashi” në Gurakoc.

Mirepo nga pretendimet ankimore Paneli ka vërtetuar se vendosja e reklamave nga subjekti politik LDK respektivisht kandidatet e këtij subjekti Besim Mulaj dhe Lisa Rugovaj nuk kanë të bëjnë vendin e dedikuar ne baze te pëlqimit te dhënë por materialet reklamuese – posteret e tyre jane vendosur ne rrugët publike, në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës “Skenderbeu”, në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës “UÇK”, në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës “Fehmi Agani”, në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës

“Bardh Isufi” dhe në shtyllat elektrike dhe ndriçuese të rrugës “Lidhja e Pejës” në Istog, dhe se veprimet e tilla paneli i konsideron si shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtresuesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Paneli me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë ka marrë për bazë faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë përpjekje te arsyeshme për ti evituar disa nga shkeljet, duke ofruar foto nga rrugët ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e kodit zgjedhor.

Gjithashtu Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e posterëve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në hapësira publike gjegjësisht në rrugët publike për të cilat nuk posedojnë Pëlqim nga Komuna e Istogut, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën saktësisht e sanksionuar me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe të njëjtit subjekt politik për të njëjtën shkelje i është shqiptuar gjobë nga PZAP-i, me Vendimin Anr.65/2024 datë 20.01.2025.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.96/2025 datë 23.01.2025

**Kryesuese e Panelit  
Kymete Kicaj**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij ven